



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 3359/1 prot.

Tiranë, më 26/01 2023

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRËS "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. 42923 prot., datë 05.12.2022 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. 75 prot., datë 19.01.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 3359 prot., datë 25.01.2023 si më poshtë vijon:

"Sa i përket kërkesës "A ju është marrë mendim për rishikimin e kufijve të zonës së mbrojtur para miratimit të VKM nr. 59, datë 26.1.2022 "Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura, ju bëjmë me dije se VKM nr. 59, datë 26701/ 2022 nuk trajton sipërfaqe që i Përkasin Bashkisë Tiranë, por territore të administruara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura AKZM-Ministria e Mjedisit. Për këtë arsye nuk na është kërkuar opinion nga Bashkia Tiranë.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se ndarja e zonave është bërë në vitin 2016 mes AKZM dhe Bashkisë Tiranë, kohë kur dhe ekonomitë pyjore kaluan në administrim të Bashkisë Tiranë. Bashkia Tiranë, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me një grup të përbashkët pune, i përbërë nga specialistë në fushën e pyjeve të pushtetit qendror dhe atij vendor, hartuan VKM-në 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive".

Qëllimi i kësaj VKM-je ishte ndarja e pyjeve ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror dhe konkretisht: Pyjet që administrohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe pyjet që administrohen nga Bashkia Tiranë. Në vitin

2021 Kompania DATECH kreu azhurnimin e V.K.M-së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive" dhe u hartua V.K.M-ja nr. 134, datë 03.03.2021, mbi bazën e të cilës u krye hipotekimi i pyjeve".

Lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

